



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINUTAT E DISKUTIMEVE

TAKIM I GRUPIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË POLITIKAVE (GMIP) PËR MIRËQEVERISJEN DHE ADMINISTRIMIN PUBLIK

Vendi: COD – Qendra për Hapje dhe Dialog, Zyra e Kryeministrit

Data: 16 May 2018

Drejtuar nga: Znj. Senida Mesi, Zëvendësministër

Lista e pjesëmarrjes është në Aneksin 1

1. Mirësearchja dhe prezantimi me Agjendën nga Zëvendëskryeministri, Znj. Senida Mesi:

Në fjalën e saj të hapjes Znj. Mesi vlerësoi mjaft pjesëmarrjen në këtë takim të GMIP për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik nga autoritetet publike, donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile. Ajo vuri në dukje rëndësinë e GMIP-së për të siguruar menaxhimin në mënyrë të integruar, koherent, efektiv dhe të orientuar drejt rezultateve të të gjitha proceseve sektoriale dhe financiare. Qeveria është duke zhvilluar një sërë reformash për të progresuar lidhur me pesë prioritetet kyçe të Integritimit Evropian që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Fiancave Publike, Decentralizimin, Shërbimet Publike, Agjendën Digjitale, Antikorrupsionin dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, etc. GMIP duhet të shërbejë si një mjet për të promovuar bashkëpunimin e brendshëm ndërministror si dhe për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse në harmonizimin e politikave dhe strategjive të zhvilluara për sektorët dhe nënsektorët e mirëqeverisjes.

GMIP është një grup pune i nivelit të lartë, që ka si anëtarë të emëruar përfaqësues të ministrive përkatëse dhe të gjitha agjencive qeveritare të cilat lidhen me qeverisjen e mirë dhe sektorin e administratës publike. Të ftuar janë gjithashtu partnerët për zhvillim dhe integrim dhe përfaqësues nga shoqëria civile me qëllim që të sigurohet përfshirja e të gjithë aktorëve në këtë sektor.

Takimi do të përqëndrohet në rekomandimet e bëra nga SIGMA në raportin e fundit të vlerësimit për Shqipërinë, si dhe në planin e rishikuar të veprimit për strategjinë e reformës së administratës publike dhe raportin e saj të monitorimit për 2017.

2. Çështjet e diskutuara gjatë takimit

Tema 1: Detyrat dhe roli i GMIP-së; kalendari dhe procedurat e GMIP-së së Mirëqeverisjes

Drejtori i Njesisë së Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, pranë Zyrës së Kryeministrit, Znj. Oriana Arapi, nënvijëzoi në prezantimin e saj disa nga tiparet më të rëndësishme të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisje. Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes luan rolin e Sekretariatit të Përgjithshëm për këtë GMIP si dhe siguron mbështetjen teknike, koordinim dhe

mbështetje në lidhje me aktivitetet e gjashtë grupeve tematike që ky grup përfshin. Secili grup tematik udhëhiqet nga institucione të ndryshme:

- Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore - Departamenti i Administratës Publike;
- Decentralizimi - Ministria e Punëve të Brendshme
- Derregullimi dhe Shërbimet - ADISA dhe Kabineti i Zëvendëskryeministrit;
- Antikorrupsioni - Ministria e Drejtësisë;
- Hartimi i politikave - Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Zyra e KM.
- E-Gov - Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit

Është siguruar që të gjithë aktorët e tjerë të jenë pjesë e grupeve tematike, sidomos donatorët kryesorë, anëtarët e shoqërisë civile etj. Ky takim është shumë i rëndësishëm pasi përqëndrohet në elementet kyçe të qeverisjes së mirë që janë vendimtare edhe për procesin e Integritimit në BE.

- Në fjalën e tij, Z. Mario Mariani, Shef i Bashkëpunimit në Delegacionin e BE në Tiranë, shprehu vlerësimin e tij për takimin, pjesëmarrjen e lartë të të gjithë aktorëve relevantë dhe theksoi disa pika kyçe:
 - Nevojën për të siguruar pronësinë e qeverisë dhe nevojën për një udhëheqje më të fortë të Qeverisë;
 - Nevojën për qartësimin dhe krijimin e strukturave të koordinimit të donatorëve dhe dialogut të politikave. Partnerët zhvillimor mbeten të hapur ndaj qasjes së zgjedhur nga Qeveria;
 - Prioritizimin e Planit Kombëtar për Integritimin Europian (NPEI) dhe lidhja e NPEI me PBA dhe programin legjislativ të qeverisë;
 - Kostim më i mirë e strategjive të ndryshme të qeverisë dhe lidhja me PBA;
 - Rëndësia e Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit dhe angazhimi i qeverisë për zbatimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit si AFMIS, EAMIS, IPSIS.

Tema 2: Raportim nga Institucionet mbi:

- (i) progresin e bërë në kuadër të rekomandimeve të SIGMA / BE, dhe**
- (ii) rekomandimeve të Grupit të posaçëm PAR**

- Përfaqësuesit nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS) dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimeve Sociale (MSHSS) theksuan arritjet kyçe në kuadër të Reformës së Derregullimit:

Reforma e Derregullimit në arsim ka rezultuar deri tani në një proces të suksesshëm, me një ndikim të qartë në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, p.sh:

- Procesi i Derregullimit në Arsimin Parauniversitar dhe Arsimin e Lartë ka rezultuar në reduktimin e numrit të dokumenteve në 86;
- Nëpërmjet eliminimit të 23 dokumenteve që kërkonin noterizimin, ministria kursen 13,800 ALL / 46 orë.

Disa elemente që u theksuan në lidhje me procesin e Derregullimit në shërbimet shëndetësore dhe sociale:

- Vendosmëria e Ministrisë për të përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve dhe për të zvogëluar burokracinë në marrjen e shërbimeve shëndetësore dhe sociale;
- Vendosmëria e Ministrisë për të luftuar korrupsionin, të rrisë transparencën dhe llogaridhënien;
- Të ulë kohën e pritjes dhe numrit të dokumenteve të nevojshme për të marrë shërbime shëndetësore dhe sociale;

- Procedurat për disa programe sociale janë thjeshtuar;
 - Është reduktuar dokumentacioni për Programin e Ndhmës Ekonomike;
- Përfaqësuesi i Ministrisë për Evropë dhe Punë të Jashtme paraqiti pikat kryesore në progresin e bërë nga ministria lidhur me rekomandimet e SIGMA-s:
- Plani Kombëtar për Integrimin Europian 2018-2020 u miratua në Këshillin e Ministrave. Ai ka të reflektuara rekomandimet e Komisionit Evropian;
 - MEPJ ka siguruar përputhjen e PKIE me programin analitik të projekt-akteve në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, i cili kontrollon dhe garanton unitetin e procesit legjislativ;
 - Ristrukturimi i grupeve ndër-institucionale të punës pritet të lehtësojë koordinimin ndër-institucional dhe përgatitjen drejt pranimit në BE;
 - Në bashkëpunim me projektin SMEI VI, të financuar nga BE, ministria po analizon mekanizmin e koordinimit ndër-institucional për procesin e anëtarësimit. MEFA po vlerëson cilat struktura do të mbeten të paprekura dhe cilat duhet të ristrukturohen.
 - Metodologjia e re e rishikuar për përgatitjen e PKIE do të fokusohet në lidhjen midis objektivave strategjike dhe PKIE.
- Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, theksoi aspektet kyçe të reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) si dhe hapat në lidhje me rekomandimet e SIGMA në fushat e mëposhtme kryesore:
- a) Procesi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një nga fushat kyçe që ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Puna ka vazhduar për të përmirësuar modulën / udhëzimet aktuale të PBA-së dhe futjen e buxhetimit të performancës, një proces që ka filluar së fundmi të zbatohet. Në shkurt të vitit 2018, ministria nxori udhëzimet lidhur me standardet për procesin e përgatitjes së buxhetit që lehtëson procesin e PBA-së;
 - b) Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik - Përveç Drejtorisë së dedikuar për Menaxhimin e Financave Publike, MEF tashmë ka krijuar dy struktura që funksionojnë rregullisht: Komitetin Drejtues dhe Komitetin Teknik. Rishikimi i Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike pritet në shtator;
 - c) Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) - Strategjia afatmesme e përgatitur nga KLSH u miratua në dhjetor 2017. KLSH do të ketë nevojë për më shumë kohë / punë në kuadër të qasjes bazuar tek risku;
 - d) Prokurimi Publik - Në prill të vitit 2017 është miratuar një ligj i ri për prokurimin publik i cili parasheh rritjen e transparencës dhe rritjen e pavarësisë së komisionit;
 - e) Parandalimi i borxheve të reja është theksuar si një çështje me rëndësi të madhe. MFE ka lëshuar udhëzime dhe po përgatit një plan trevjeçar për shlyerjen e borxheve.
- Përfaqësuesi i Departamentit Rregullator dhe i Përputhshmërisë në ZKM, dha një pasqyrë mbi krijimin dhe zhvillimin e procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR) dhe mbështetjen e ofruar nga SIGMA. Në shkurt të vitit 2017, njësisë e VNR u krijua në Zyrën e Kryeministrit dhe rrjetin e VNR, i cili po merr masa për të ofruar trajnime dhe mjete për procesin e VNR-së.
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, theksoi disa arritje në lidhje me shtyllën e llogaridhënies së Raportit SIGMA:
- Amendimi i Ligjit për të Drejtën e Informacionit është 90% i përfunduar;

- Të gjitha ministratë tashmë kanë programe transparence dhe kanë caktuar një koordinator për të drejtën e informimit;
- Të gjitha bashkitë, deri në fund të vitit 2018 do të kenë një program të transparencës;
- Që nga marsi i vitit 2018, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin që i detyron të gjitha institucionet të kenë një regjistër qendror / online dhe regjistrin e përgjigjeve;

Tema 3: Diskutimi dhe miratimi i planveprimit të rishikuar të Strategjisë SNRAP për 2018-2020 dhe i raportit të monitorimit të SNRAP për vitin 2017

- Drejtori i Departamentit të Administratës Publike (DAP) dha një prezantim mbi rishikimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Reformën e Administratës Publike dhe disa gjetje mbi raportin e monitorimit (raporti i tretë vjetor i monitorimit) i strategjisë së përgatitur nga DAP në katër shtylla:
 - Hartimi i politikave dhe cilësia e legjislacionit
 - Organizimi dhe funksionimi i administratës publike
 - Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
 - Procedurat administrative

Disa nga arritjet e përmendura në Raportin e Monitorimit për vitin 2017 janë:

- Në të katër shtyllat e saj, zbatimi i strategjisë është 70%;
- Ka pasur zhvillime të suksesshme me AFMIS, EAMIS, IPSIS përsa i përket ndërtimit të sistemeve të menaxhimit të informacionit në përmirësimin e hartimit të politikave dhe koordinimit;
- Ka pasur zhvillime në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike me hapjen e tre qendrave të reja të integruara publike në Krujë, Fier dhe Gjirokastrë;
- Ristrukturimi i administratës shtetërore;
- Ka pasur progres në drejtim të përmirësimit të procedurës së rekrutimit nëpërmjet trajnimit të anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes;
- Zgjerimi i HRMIS;
- Zbatimi i programit të transparencës nga autoritetet publike.

Plani i ri i Veprimit të Strategjisë për Reformën e Administratës Publike (PAR) 2018-2020 është publikuar në internet. Kostoja e saj ka përfunduar duke treguar një hendek 8% në financim.

- Në ndërhyrjen e tij të mbylljes, Z. Mario Mariani, Shefi i Bashkëpunimit në Delegacionin e BE-së theksoi disa pika kyçe:
 - Kostimi i Strategjisë së RAP-it - duhet të ndahet dhe diskutohet me palët e interesit duke përfshirë partnerët e zhvillimit;
 - Nevoja për të vështuar njësitë e qeverisjes vendore dhe zbatimin e LSHC-së në nivel lokal kur rishikohet Strategjia e RAP;
 - Grupi tematik mbi decentralizimin / qeverisjen vendore ka konfirmuar sfidat në drejtim të burimeve njerëzore. Duhet të zhvillohet një diskutim i mëtejshëm me partnerët e zhvillimit se si të mbështetet fuqizimi dhe forcimi i pushtetit lokal;
 - Anti-korrupsioni është një fushë që nuk është prekur; Plani i Veprimit Anti-korrupsion është miratuar pa u konsultuar;
 - Prioritizimi i Planit Kombëtar për Integrimin Europian (NPEI) dhe lidhja e NPEI me PBA dhe programin legjislativ të qeverisë;
 - Rëndësia e Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit dhe angazhimi i qeverisë për zbatimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit si AFMIS, EAMIS, IPSIS;
 - Kosto më e mirë e strategjive të ndryshme të qeverisë dhe lidhja me PBA;

- Sa i përket procesit të ristrukturimit të qeverisë dhe ndikimit të saj ndaj stafit, do të ishte mirë që të ketë një dialog të hapur mbi mënyrën se si perceptohet ristrukturimi dhe mësimet e nxjerra - është një temë e rëndësishme për një takim të një Grupi Tematik.

Konkluzione dhe Hapat në Vijim:

Znj. Mesi përfundoi takimin duke nënvizuar disa rekomandime:

- U miratua Plani i Ri i Veprimit 2018-2020 për Strategjinë e Administratës Publike dhe Raportin mbi Monitorimin 2017 për Strategjinë e RAP;
- Ministria e Drejtësisë duhet të paraqesë një Raport mbi Strategjinë Kundër Korrupsionit;
- Planifikim dhe monitorim më i mirë nga të gjitha ministritë e linjës;
- Buxhetimi i strategjive duhet të adresohet siç duhet;
- Një Plan i qartë Veprimi për Rekomandimin e SIGMA-s për çdo institucion përkatës do të ndiqet nga Sekretariati Teknik në bashkëpunim të ngushtë me ministritë e linjës;
- Takimi i dytë i GMIP për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike duhet të zhvillohet në qershor për të diskutuar tema si Antikorrupsioni dhe Qeverisja Lokale, Raportimi i progresit në Planin e Veprimit për rekomandimet e SIGMA.

Annexes:

Aneks 1 – Lista e pjesëmarrësve

Aneks 2 – Prezantimi 1: Mekanizmi i GMIP & roli dhe përgjegjësitë lidhur me Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik

Aneks 3 – Prezantimi 2: Raporti i Monitorimit të SNRAP dhe Plani i ri i Veprimit

Aneks 4 – Raporti i aprovuar i Monitorimit të SNRAP për 2017

Aneks 5 – Plan Veprimi i aprovuar i SNRAP 2018-2020

Aneks 6 – Paketa e GMIP për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik (Guida e Rregullave dhe Procedurave & Anekset)